

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-153/2015

Prishtinë,
20 shtator 2017

Në çështjen juridike të:

M. Z.

Pala ankuese

kundër

Nuk ka

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, Gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/248/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA27273), të datës 18 qershor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 20 shtator 2017 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. Z. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/248/2014, të datës 18 qershor 2014, për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA27273.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/248/2014, i datës 18 qershor 2014, për sa i takon kërkesës me numrin KPA27273.

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale

1. Më 23 mars 2007, M. Z. (në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP) ku kërkonte rripesedimin e lokalit afarist. Ajo pretendon të jetë bashkëpronare e lokalit afarist me sipërfaqe prej 30.45 m², që ndodhet në rrugën “Dardania” nr. 16, Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar).
2. Pala ankuese sqaroi se është bashkëpronare e pronës se kërkuar duke theksuar se bashkëpronarja tjetër është O. C-T. Sipas palës ankuese e drejta mbi pronën e kërkuar ishte humbur më 22 mars 1999, si rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt dhe 20 qershor 1999.
3. Për të mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese kishte dorëzuar në AKP provat vijuese:
 - Vendimin nr. 07-361-451, të lëshuar nga Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Prishtinës më 16 mars 1992, me të cilën ishte miratuar kërkesa e O.C, për të blerë lokalin afarist nr. 16 me sipërfaqe prej 30.45 m², që ndodhej në rrugën Dardania-Prishtinë.
 - Kontrata e shitblerjes së lokalit afarist përmes Kredisë nr. 1336, e lidhur më 6 prill 1992 në mes të Kompanisë Ndërtimore “Granding” në cilësi të shitësit dhe O. C. në cilësi të blerëses.

- Faturën e datës 14 prill 1992 me të cilën shihet se O. C-T i kishte paguar shumën prej 1.593.053 dinarësh (valutë jugosllave) Kompanisë Ndërtimore “Gradning” në emër të shitblerjes së lokalit afarist.
 - Procesverbalin e lëshuar nga Kompania Ndërtimore “Granding” në të cilin shkruhet se më 6 shtator 1993 O.C-T kishte pranuar çelësat e pronës së kërkuar.
 - Autorizimin e legalizuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës më 30 maj 1996 me numrin nr. 1365/96 me të cilin O. T. e kishte autorizuar M. J.që ajo, në cilësinë e bashkëpronares të mund të ndërmernte të gjithë hapat e nevojshëm për përshtatjen dhe zgjerimin e pronës së kërkuar.
4. Identifikimi i kërkesës ishte bërë më 14 janar 2008 ku ishte vërtetuar se prona e kërkuar ishte një dyqan që përdorej nga G. B. B nuk pretendonte të drejtë ligjore mbi pronën dhe nuk kishte marrë pjesë në procedurën para AKP-së. Pasi që asnjë palë nuk kishte paraqitur përgjigje në kërkesë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079 kërkesa ishte konsideruar si e pa kontestuar.
 5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk arriti të gjejë asnjërin nga provat e dorëzuara nga pala ankuese përkundër përpjekjeve të saj, prandaj verifikimi i provave rezultojë të jetë Negativ.
 6. Pala ankuese ishte kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së dhe ishte udhëzuar të paraqiste prova shtesë për të dëshmuar të drejtën e saj sepse dokumentet që ajo kishte dorëzuar nuk mbështesin të drejtat e saj mbi pronën e kërkuar dhe gjithashtu ato nuk ishin gjetur në institucionet kompetente.
 7. Për më tepër, si përpjekje shtesë, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së i kishte dorëzuar palës ankuese një letër informuese ku kërkonte nga ajo të dorëzonte dokumente shtesë dhe ku e informonte atë se nëse ajo nuk i dorëzonte dokumentet e kërkuara kërkesa mund të refuzohej nga Komisioni. Letra ishte pranuar nga pala ankuese më 26 gusht 2013. Në përgjigje të letrës, ajo kishte dorëzuar edhe një herë dokumentet e njëjta.
 8. Më 18 qershor 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/C/248/2014 e kishte refuzuar kërkesën e palës ankuese me arsyetimin se ajo nuk e kishte dëshmuar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit gjatë viteve 1998-1999.
 9. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese më 1 dhjetor 2014, ndërsa ajo kishte paraqitur ankesë më 24 dhjetor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese ka kundërshtuar vendimin e KKPK-së duke theksuar se vendimi mbështetet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe mbi shkeljen e të drejtës materiale dhe asaj procedurale.
11. Sipas palës ankuese, O.C. është pronare e pronës së kërkuar bazuar në provat e dorëzuara. Ajo nuk e ka të qartë se përse është refuzuar kërkesa dhe përse Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk ka mundur të verifikoj dokumentet që e dëshmojnë të drejtën e saj bashkë-pronësore përkundër faktit se sipas saj, ajo ka dorëzuar provat me të cilat mund të shihet se ajo është bashkëpronare.
12. Pala ankuese përsërit pretendimet e njëjta si në shkallë të parë duke prezantuar sërish dokumentet e njëjta të cilët tashmë ishin marrë në konsideratë nga KKPK-ja.

Arsyetimi ligjor**Pranueshmëria e ankesës**

13. Ankesa ishte paraqitur brenda 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

Meritat e ankesës

14. Gjykata Supreme shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 (në tekstin e mëtejme: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese gjeti se ankesa është e pabazuar.
15. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marr vendim të drejtë kur ka refuzuar kërkesën.
16. Sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedimin e pronës, nëse paraqitësi i kërkesës “e dëshmon” të drejtën e tij pronësore apo të drejtën për shfrytëzimin e pronës private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, dhe gjithashtu e dëshmon se ai /ajo nuk është në gjendje të ushtroj të drejtën në fjalë për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e

armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo për shkak të rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.

17. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese është dashur të dorëzonte prova në mbështetje të kërkesës së saj për të dëshmuar të drejtën e pronësisë/bashkëpronësisë apo të drejtën për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme.
18. KKPK-ja e mbështet vendimin e saj mbi faktin se pala ankuese nuk ka dorëzuar asnjë provë që ka mundur të verifikohet nga AKP-ja, se ajo si bartëse e të drejtës pronësore gëzon ndonjë të drejtë bashkëpronësie mbi pronën, si dhe në faktin se Sekretaria Ekzekutive *ex officio* nuk kishte gjetur prova të tilla.
19. Prova e vetme që i referohet palës ankuese si bashkëpronare është Autorizimi nr. 1365/96 i cili ishte legalizuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës më 30 maj 1996. Megjithatë, autorizimi nuk ka asnjë vlerë juridike për të dëshmuar të drejtën e bashkëpronësisë mbi pronën e kërkuar.
20. Të gjitha provat i referohen O. C.-T.si pronare e vetme e pronës së kërkuar, ndërsa pala ankuese nuk është përmendur në asnjërën nga provat. Gjithashtu, këto dokumente nuk ishin gjetur në institucionet përkatëse që i kishin lëshuar ato, gjë që shpie në konstatimin se edhe e drejta e pretenduar e O. C. mbi pronën e kërkuar nuk ishte dëshmuar.
21. Ankesa e palës ankuese ri-sjell pretendimet e njëjta që ajo i kishte theksuar para KKPK-së. Me ankesën ajo nuk kishte dorëzuar asnjë provë të re.
22. Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka lëshuar vendim të drejtë dhe të bazuar pas një procedure të rregullt. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.
23. Nga ajo që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafi (c) të Ligjit nr. 03/L-079 është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Referente i EULEX-it